



FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVO

Komisioni Disiplinor dhe i Etikës i shkallës së parë në përbërje prej: Metë Çeku – kryetar, Avni Shala dhe Donat Lushaku – anëtarë, duke u mbështetur në nenin 63, paragrafi 1, dhe paragrafi 4, nenin 66, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, pika i), të Statutit të FFK-së, si dhe nenit 8, paragrafi 4, pika i), nenit 60, paragrafi 1, pika f), nenit 91, dhe 92, pika b) të Rregullores Disiplinore të FFK-së, nenit 51, paragrafi 1, nenit 52, paragrafi 1, pika n) dhe nenit 53 të Propozicioneve të Garave 2023/2024, në mbledhjen e mbajtur me datë 12.04.2024 në ora 13:00 shqyrtoi procedurën e inicuar disiplinore të Komisionit të Garave të datës 11.04.2024 ndaj KF “Ulpiana 1926” nga Lipjani dhe KF “Vllaznia-Pozheran” nga Pozherani-Viti, për kurdisje të rezultatit në ndeshjen e rregullt të xhiros së XXI-të Raiffeisen Liga e Parë (Grupi B), merrë këtë:

V E N D I M

Klubi Futbollistik “Vllaznia - Pozheran” nga Pozherani, Viti **LARGOHET** nga garat e rangut përkatës të Raiffeisen Ligës së Parë të Futbollit (Grupi B) të edicionit 2023/2024, ashtu që i njëjti kthehet në rang më të ulët të garave dhe me këtë humb statusin e anëtarit të Ligës së Parë për edicionin 2023/2024, kurse garat e rregullta nga kampionati vijues 2024/2025 i zhvillon në Ligën e Dytë të futbollit.

A r s y e t i m

Më datë 07.04.2024 me fillim nga ora 15:00 është zhvilluar ndeshja kampionale (xhiro XXI) e Raiffeisen Liga e Parë (Grupi B) në mes të KF “Ulpiana 1926” Lipjan dhe KF “Vllaznia (P)” nga Pozherani, në Stadiumin “Sami Kelmendi” në Lipjan. Rezultati final u përfundua me shifrat 3:4 në favor të ekipit mysafir.

Bazuar në raportin zyrtar të delegatit të ndeshjes, z. Shkelzen Jashanica, evidentohet që në pjesën e dytë të ndeshjes, ekipi vendas tregoi një mungesë të qartë angazhimi në lojë, qëllimisht duke lejuar hapësira të shumta për kundërshtarët dhe duke lehtësuar punën për ekipin mysafir. Kjo situatë u reflektua edhe në shënimet e golave, duke bërë të mundur kthesën e rezultatit nga 3:1 në favor të ekipit mysafir në 3:4.

Përtej kësaj, në minutat e fundit të ndeshjes ekipi vendas kishte mundësi reale për barazim të rezultatit, por që pavarësisht mundësisë e hapësirës që nga 4-5 metra të shënohej, nuk u qëllua fare perimetri i portes.

Përveç raportit të lartcekur, ekzistojnë edhe xhirimet televizive, të cilat janë përdorur si prova materiale edhe nga Komisioni i Garave i Superligës dhe Ligës së Parë, të cilat vërtetojnë mungesën e angazhimit të ekipit vendas, i cili shprehimisht në nenin 60, paragrafi 1, pika e), e Rregullores Disiplinore përkufizohet si *“lëshim i qëllimshëm i kundërshtarit të shënoj gol pa angazhim, angazhim inert, mos dëshirë për lojë, dëmtim i ekipit të tij me qëllim”*.



FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVO

Veprime të tilla, pra të mosangazhimit, në rastin konkret të ekipit vendas shihen në shënimin e golit të tretë dhe të katërt të ekipit mysafir, si dhe mosrealizimit të mundësisë për gol të ekipit vendas në minutat e fundit të takimit. Ky rezultat ka ndikuar edhe në gjendjen e pikëve të pjesës së poshtme tabelare në Raiffeisen Liga e Parë.

Gjithashtu, komunikimet e lojtarëve me mesazhe telefonike lidhur me zhvillimin dhe rezultatin e ndeshjes si dhe të dhënat nga raportet tjera konfidenciale paraqesin prova të mjaftueshme për vendimmarrje në çështjen e iniciuar nga Komisioni i Garave.

Andaj bazuar në këto gjendjen faktike të lartcekur,, Komisioni Disiplinor dhe i Etikës vendosi sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht për largimin e Vllaznia - Pozheran“ nga Pozherani nga garat e rangut përkatës ashtu që të njëjtit do të rangohen në gara të nivelit më të ulët dhe me këtë humb statusin e anëtarit të Ligës së Parë për edicionin 2023/2024, kurse garat e rregullta nga kampionati vijues 2024/2025 i zhvillon në Ligën e Dytë të futbollit.

Prishtinë, 12.04.2024

Komisioni- Disiplinor dhe i Etikës - shkalla e parë

Kryetar: Metë Çeku

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese në afatin kohor prej 8 (tetë) ditësh, nga data e pranimit të vendimit në web faqen zyrtare të FFK-së, përmes këtij Komisionit, tek Komisioni i Ankesave. Ankesa e ushtruar nga ana e palës së ankimuar nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.